

MANUALI INSTITUCIONAL PËR HARTIMIN E KATALOGËVE TË STANDARDIZIMIT DHE UNIFIKIMIT NGA OBP

Specifikime Teknike & Çmime Referuese

Mallra & Shërbime

Tabela e përmbajtjes

1. Hyrje	3
2. Roli i këtij Manuali	5
3. Struktura Organizative dhe Përgjegjësitë Kryesore	7
4. Procedurat e Brendshme të Punës.....	9
5. Metodologjia e Përcaktimit të Çmimeve Mesatare	13
6. Rishikimi dhe Përditësimi i Katalogut.....	14
7. Publikimi i Katalogut	15
8. Sekreti Profesional dhe Etika në Punë.....	15
9. Modele dhe Praktika Ndërkombëtare në Përdorimin e Katalogëve të Standardizuar	15
10. Dispozita të Fundit	18

1. Hyrje

Në mbështetje të kuadrit ligjor dhe nënligjor që rregullon veprimtarinë e Shoqërisë “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sh.a., si dhe në përputhje me detyrimet e përcaktuara në Ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, dhe aktet përkatëse nënligjore, hartimi i këtij manuali përbën një domosdoshmëri institucionale për sigurimin e një administrimi të unifikuar, efikas dhe transparent të proceseve të standardizimit dhe unifikimit.

Ky dokument është konceptuar si një instrument udhëzues dhe detyrues për të gjitha strukturat dhe punonjësit e përfshirë në këtë proces, duke synuar krijimin e një baze të qartë rregullash dhe metodash pune, të harmonizuara me standardet më të mira të praktikës administrative dhe të menaxhimit publik. Ai përfaqëson një mjet themelor për:

- Garantimin e koherencës dhe uniformitetit në procedurat e brendshme;
- Forcimin e transparencës dhe përgjegjshmërisë institucionale;
- Rritjen e cilësisë dhe besueshmërisë së proceseve të prokurimit publik;
- Optimizimin e përdorimit të burimeve dhe fondeve publike, në përputhje me parimet e efikasitetit dhe ekonomicitetit.

Qëllimi i Manualit

Në kushtet e zhvillimit të tregut, të rritjes së kompleksitetit të mallrave dhe shërbimeve të prokuruar, si dhe të domosdoshmërisë për të administruar në mënyrë sa më efektive fondet publike, roli i një Organi Qendror Blerës merr një rëndësi strategjike në arkitekturën e sistemit të prokurimeve publike.

Institucione të tilla, si “Operatori i Blerjeve të Përqendruara” sh.a., nuk janë vetëm një hallkë ekzekutuese e procedurave të prokurimit; ato janë një mekanizëm kyç për garantimin e transparencës, konkurrencës së ndershme dhe përdorimit me përgjegjësi të buxhetit të shtetit. Në këtë kuadër, standardizimi i specifikimeve teknike dhe unifikimi i çmimeve nuk janë thjesht praktika të mira administrative, por kushte themelore për realizimin e mandatit ligjor dhe për krijimin e besimit publik në proceset e blerjeve të centralizuara.

Pse është i domosdoshëm standardizimi i specifikimeve teknike?

Pa specifikime teknike të standardizuara, secili autoritet kontraktor do të hartonte termat e vet të referencës sipas perceptimit ose nevojave të tij të menjëhershme. Kjo do të sillte:

- Mospërputhje në cilësi dhe performancë mes produkteve/shërbimeve të blera;
- Vështirësi në krahasimin objektiv të ofertave;
- Mungesë të bazës së përbashkët për kontroll cilësie dhe inspektim;
- Rrezik për përfshirjen e kërkesave diskriminuese ose të formuluar në mënyrë të tillë që favorizojnë operatorë të caktuar.

Standardizimi, përkundrazi, krijon një gjuhë të përbashkët teknike që kuptohet njësoj nga të gjithë aktorët, nga hartuesit e dokumenteve të prokurimit, tek operatorët ekonomikë që konkurojnë, deri tek audituesit që monitorojnë procesin.

Pse është thelbësor unifikimi i çmimeve?

Njësoj si specifikimet teknike, edhe çmimet duhet të kenë një pikë referimi të unifikuar. Pa këtë, rrezikohet që mallra apo shërbime të njëjta të prokurohen me diferenca të mëdha çmimi, shpesh të pajustificuara nga kushtet e tregut. Ky fenomen:

- Kompromenton efikasitetin e përdorimit të fondeve publike;
- Nxit perceptimin e mungesës së transparencës;
- Vështirëson prokurimin dhe planifikimin buxhetor;
- Ul fuqinë blerëse që një organ qendror mund të arrijë përmes efekteve të volumit.

Unifikimi i çmimeve, i bazuar në testimin sistematik të tregut dhe analizën e të dhënave zyrtare, krijon një bazë reale dhe të verifikueshme për vlerësimin e ofertave dhe për garantimin e trajtimit të barabartë të operatorëve.

Përfitimet strategjike

Një sistem i konsoliduar i standardizimit dhe unifikimit të çmimeve sjell përfitime të shumëfishta për të gjitha palët:

1. Për organin qendror blerës

- Rrit efikasitetin operacional dhe ul kohën e përpunimit të procedurave;
- Siguron koherencë në të gjitha kontratat dhe procedurat e blerjes;
- Ofron bazë të fortë për raportim dhe auditim.

2. Për autoritetet kontraktore

- Marrin produkte dhe shërbime me cilësi të garantuar dhe të njëtrajtshme;
- Kursejne kohë për të hartuar specifikimet teknike nga e fillimi;
- Përfitojnë nga unifikimi çmimeve të cilat janë më konkurruese falë efekteve të volumit/sasisë.

3. Për operatorët ekonomikë

- Kanë kushte të qarta dhe të njëjta konkurrence;
- Reduktohet pasiguria dhe kostot përgatitore të ofertave;
- Shtohet mundësia për pjesëmarrje të gjerë dhe konkurrencë reale.

4. Për publikun dhe audituesit

- Sigurohet transparencë dhe gjurmueshmëri e plotë e procesit;
- Lehtësohet verifikimi i përdorimit të fondeve publike;
- Forcohet besimi në integritetin e sistemit të prokurimeve.

2. Roli i këtij Manuali

Ky manual përfaqëson mjetin praktik dhe normativ që udhëzon të gjithë procesin nga identifikimi i artikujve dhe hartimi i specifikimeve teknike, tek testimi i tregut, miratimi, publikimi, zbatimi dhe rishikimi periodik i katalogëve. Ai është hartuar për t'u përdorur jo vetëm nga stafi i OBP-së, por edhe për t'u kuptuar dhe vlerësuar nga audituesit e brendshëm dhe të jashtëm, autoritetet kontraktore, si dhe operatorët ekonomikë.

Çdo hap i përshkruar në këtë manual është i ndërtuar mbi parimin e ligjshmërisë, paanshmërisë dhe transparencës, dhe i mbështetur nga praktikat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e prokurimeve publike.

Nëpërmjet zbatimit rigoroz të procedurave të parashikuara këtu, OBP-ja vendos themelet e një sistemi blerjesh publike të bazuar në standarde të larta teknike dhe ekonomike, duke siguruar që çdo lek i buxhetit të shpenzohet në mënyrë të përgjegjshme, efikase dhe në shërbim të interesit publik.

Ai synon të ofrojë një kornizë të qartë procedurale, ku çdo hap është i dokumentuar, i justifikuar dhe i bazuar në standardet ligjore e teknike më të avancuara, duke garantuar se të gjitha autoritetet kontraktore dhe operatorët ekonomikë punojnë mbi të njëjtat parime dhe të njëjtat kritere cilësie.

Nevoja për këtë manual lind nga kërkesa për uniformitet, transparencë dhe efikasitet në proceset e prokurimit publik.

Pa një metodologji të unifikuar për hartimin e katalogëve, ekziston rreziku i mospërputhjes së specifikimeve teknike, çmimeve të paqëndrueshme dhe vendimmarrjeve të pakoordinuara, që mund të çojnë në shpenzime joefikase të fondeve publike dhe në ulje të cilësisë së mallrave dhe shërbimeve të blera.

Ky dokument shërben si instrument strategjik për të gjitha strukturat e OBP-së, duke përcaktuar jo vetëm hapat teknikë, por edhe filozofinë e punës që duhet ndjekur për të garantuar cilësi të qëndrueshme, çmime të drejta dhe konkurrencë të ndershme.

Ky manual nuk është një dokument statik. Ai është një mjet dinamik, i ndërtuar për t'u përmirësuar dhe për t'u përshtatur vazhdimisht me ndryshimet ligjore, zhvillimet e tregut dhe teknologjitë e reja.

Nëpërmjet tij, OBP-ja riafirmon angazhimin për të mbajtur standardet më të larta të integritetit dhe profesionalizmit, duke e kthyer procesin e prokurimeve publike të përqendruara në një shembull për transparencë dhe efikasitet në shërbim të interesit publik.

Në këtë manual percaktohen në mënyrë të qartë detyrat, përgjegjësitë dhe procedurat e punës në kuadër të veprimtarisë së Sektorit të Standardizimit dhe Unifikimit. Synimi është të garantohet një qasje e strukturuar dhe e qëndrueshme në procesin e unifikimit të specifikimeve teknike dhe të çmimeve për objektet e prokurimit, duke

siguruar përmirësimin e vazhdueshëm të efikasitetit, transparencës dhe cilësisë institucionale. Manuali është i detyrueshëm për zbatim nga të gjithë punonjësit përkatës dhe zbatohet në përputhje të plotë me VKM nr. 531, datë 7.9.2023, të ndryshuar me VKM nr. 768, datë 13.12.2024.

Baza Ligjore dhe Rregullatore

Ky manual mbështetet në:

- Ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;
- VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;
- VKM nr. 531, datë 7.9.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore ‘Operatori i Blerjeve të Përqendruara’ sh.a për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik”, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, ministrive dhe institucioneve të varësisë, i ndryshuar me VKM nr. 768, datë 13.12.2024.
- “Rregulloren e Brendshme të Shoqërisë Operator i Blerjeve të Përqendruara”;

Në kuadër të detyrave funksionale, Sektori i Standardizimit dhe Unifikimit ka përgjegjësi të standardizojë dhe/ose unifikojë specifikimet teknike për mallrat, shërbimet dhe punimet e prokuruar, duke u mbështetur në praktika të mira administrative, konsultim të vazhdueshëm me institucionet përgjegjëse dhe përfshirjen e ekspertizës së brendshme dhe të jashtme, vendase ose të huaj.

Ky manual është pjesë integrale e mekanizmave rregullatorë të OBP.

3. Struktura Organizative dhe Përgjegjësitë Kryesore

Struktura organizative e Sektorit të Standardizimit dhe Unifikimit përbëhet nga:

- Drejtori i Drejtorisë;
- Përgjegjësi i Sektorit;
- Specialistët e sektorit;
- Specialistë të fushës së jashtme (të angazhuar me kontrata bashkëpunimi).

Organizimi hierarkik siguron shpërndarjen e qartë të përgjegjësisë, koordinimin efektiv të veprimtarive dhe garantimin e cilësisë në proceset e standardizimit dhe

unifikimit. Përfshirja e specialistëve të jashtëm siguron ekspertizë shtesë dhe fleksibilitet në trajtimin e çështjeve të veçanta teknike.

1. Detyrat dhe Përgjegjësitë Kryesore të Sektorit

Sektori i Standardizimit dhe Unifikimit ushtron këto detyra kryesore:

a) Analiza dhe Hartimi i Specifikimeve Teknike

- Kryen analiza periodike për të identifikuar nevojat në hartimin dhe unifikimin e specifikimeve teknike dhe/ose termave të referencës për mallrat dhe shërbimet e të njëjtit lloj.
- Vlerëson nevojat për unifikimin e çmimeve të mallrave dhe shërbimeve, duke marrë në konsideratë faktorë të tillë si ndryshimet në specifikimet teknike, kushtet e tregut, inflacionin apo faktorë të tjerë ekonomikë.

b) Përfshirja e Ekspertizës

- Siguron përfshirjen e specialistëve të fushës nga institucionet përkatëse brenda kompetencës së tyre profesionale, si dhe të specialistëve të jashtëm, përmes kontratave të bashkëpunimit, kur kërkohet ekspertizë e specializuar.

c) Bashkëpunimi Ndërinstitucional

- Bashkëpunon ngushtë me Drejtorinë e Përgjithshme të Standardizimit për përditësimin e standardeve, duke përfshirë proceset e shfuqizimit, adaptimit apo miratimit të standardeve të reja për mallrat dhe shërbimet e përfshira në katalogët përkatës.
- Merr pjesë në procesin e blerjes së mallrave dhe shërbimeve të standardizuara kur kjo është e nevojshme për realizimin e detyrave funksionale.

d) Menaxhimi i Katalogëve të Standardizuar

- Harton, rishikon dhe mirëmban katalogët e unifikuar dhe të standardizuar, duke siguruar që ata të jenë gjithmonë të përditësuar dhe në përputhje me kërkesat ligjore dhe teknike në fuqi.

4. Procedurat e Brendshme të Punës

Procesi i unifikimit dhe standardizimit zhvillohet sipas këtyre hapave të strukturuar:

1. Identifikimi i grupit të mallrave/shërbimeve

Kryhet identifikimi i mallrave ose shërbimeve të të njëjtit lloj, që paraqesin nevojë për unifikim dhe standardizim, bazuar në prioritetet institucionale klientë të OBP-se dhe nevojat e tregut.

2. Vlerësimi i rëndësisë dhe nevojës emergjente

Në varësi të rëndësisë dhe urgjencës së kërkesave nga autoritetet kontraktore, iniciohet hartimi i një katalogu të ri ose rishikimi i një katalogu ekzistues nga Drejtoria e Standarteve.

3. Formimi i grupit të punës

Titullari i OBP-së nxjerr urdhër për ngritjen e grupit të punës, i cili do të përgatisë katalogun sipas objektit të prokurimit.

4. Bashkëpunimi për katalogët ekzistues

Për katalogët që kërkojnë rishikim apo modifikim, grupi i punës bashkëpunon me Drejtorinë Teknike dhe Drejtorinë e Shqyrtimit të Ankesave, kur objekti ka lidhje me specifikime teknike që janë bërë objekt shqyrtimi.

5. Trajtimi i ankesave dhe kërkesave për sqarim

Grupi i punës shqyrton çdo ankesë ose kërkesë për sqarim dhe reflekton ndryshimet e nevojshme në katalogun perkates kur kjo është e arsyeshme.

6. Përfshirja e ekspertëve të fushës

Në varësi të natyrës së objektit të prokurimit, në grup përfshihen një ose më shumë specialistë të fushës (të brendshëm ose të jashtëm), të cilët, së bashku me specialistë/përgjegjës të sektorit, ndihmojnë në hartimin ose rishikimin e specifikimeve teknike dhe/ose termave të referencës.

7. Afatet e dorëzimit të dokumentacionit teknik

Specialistët e fushës kanë një afat standard prej 14 ditësh pune për dorëzimin e dokumentacionit teknik. Në rast problematikash teknike të justifikuara, afati mund të shtyhet me miratimin e Titullarit ose Drejtorit të Drejtorisë.

8. Përmbajtja e specifikimeve teknike

Specifikimet teknike duhet të japin një përshkrim të qartë dhe të saktë të mallrave/shërbimeve, duke përfshirë kriteret e performancës dhe cilësisë, si dhe referencat teknike ose standardet kombëtare/ndërkombëtare të aplikueshme.

9. Konsultimi publik

Me synim transparencën dhe gjithëpërfshirjen, grupi i punës, sipas natyrës së objektit, organizon konsultime publike me operatorë ekonomikë të profilit përkatës. Sugjerimet e marra shqyrtohen dhe, nëse janë të vlefshme, pasqyrohen në versionin final të specifikimeve teknike.

Konsultimi publik me operatorët ekonomikë është një nga shtyllat kryesore të procesit të hartimit të katalogëve të standardizimit dhe unifikimit të specifikimeve teknike dhe çmimeve referuese.

Ky proces nuk është vetëm një detyrim formal, por një mekanizëm i domosdoshëm për të siguruar që dokumenti final të jetë:

- teknikisht i saktë,
- ekonomikisht i drejtë,
- dhe plotësisht i përshtatur me realitetin e tregut.

Në mungesë të një konsultimi gjithëpërfshirës, ekziston rreziku që katalogu të përmbajë specifikime që kufizojnë pjesëmarrjen, të mos pasqyrojnë teknologjitë më të fundit, ose të vendosë çmime referuese që nuk korrespondojnë me situatën aktuale ekonomike.

Përfshirja e operatorëve ekonomikë jo vetëm që ndihmon në përmirësimin e përmbajtjes teknike të katalogut, por rrit besimin e tregut në proces, nxit konkurrencën e ndershme dhe redukton ankesat e mëvonshme në procedurat e prokurimit.

Konsultimi publik duhet të bazohet mbi:

- Transparencën – të gjithë operatorët të kenë akses të barabartë në informacion dhe mundësi për të dhënë mendimin e tyre.
- Paanshmërinë – asnjë operator nuk duhet të favorizohet në trajtimin e komenteve ose në ftesën për konsultim.
- Gjurmueshmërinë – çdo koment, propozim ose sugjerim duhet të dokumentohet dhe të jetë i verifikueshëm në çdo kohë.
- Relevancën – konsultimi duhet të fokusohet tek elementet që ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë, funksionalitetin dhe koston e mallrave/shërbimeve.

9.1 Procedura e Konsultimit Publik

Njoftimi zyrtar

- OBP-ja publikon njoftimin për konsultim në faqen e saj zyrtare, nëse është e nevojshme, në platforma online ose në buletinin javor të APP.
- Njoftimi përmban:
 - listën e kategorive të mallrave/shërbimeve objekt i konsultimit;
 - draft-specifikimet teknike;
 - afatin për dorëzimin e komenteve (jo më pak se 15 ditë kalendarike);
 - formatin dhe kanalet e dorëzimit (email zyrtar, platformë online, dorëzim fizik).

Periudha e hapur e konsultimit

- Zgjat minimalisht 15 ditë kalendarike, me mundësi zgjatjeje për kategori komplekse ose me ndikim të madh buxhetor.
- Gjatë kësaj periudhe, operatorët ekonomikë mund të dërgojnë:
 - komente mbi specifikimet teknike;
 - sugjerime për teknologji ose zgjidhje alternative;
 - propozime për standarde ndërkombëtare që mund të adoptohen.

9.2 Konsultimet e drejtpërdrejta

- Për kategori strategjike, OBP-ja organizon takime të hapura (fizike ose online) me operatorët, dhomat e tregtisë dhe shoqatat profesionale.
- Takimet regjistrohen dhe përmbledhja e tyre bëhet pjesë e dokumentacionit zyrtar.

9.3 Regjistrimi dhe analiza e komenteve

- Të gjitha komentet dokumentohen në një Matricë të Komenteve, ku pasqyrohet:
 - identiteti i sugjeruesit;
 - përmbajtja e komentit;
- Kjo matricë bëhet pjesë e dosjes së miratimit të katalogut.

9.4 Raporti përfundimtar i konsultimit

- Pas përfundimit të analizës, OBP-ja përgatit një raport përfundimtar, ku tregohet në mënyrë transparente se si u trajtuan komentet dhe cilat prej tyre u integruan në versionin final të katalogut.
- Raporti publikohet së bashku me katalogun e miratuar.

9.5 Përfitimet e Konsultimit Publik

- Përmirësim i cilësisë së specifikimeve teknike përmes përvojës së drejtpërdrejtë të tregut.
- Rritje e konkurrencës falë eliminimit të specifikimeve kufizuese.
- Reduktim i riskut të ankesave ose kontestimeve ligjore.
- Përdorim më efikas i fondeve publike duke u bazuar në çmime reale tregu.
- Forcim i transparencës dhe i besimit të operatorëve ekonomikë në procesin e prokurimit publik.

10.Shqyrtimi dhe finalizimi

Pas përfundimit të punës, grupi shqyrton specifikimet teknike përfundimtare dhe përgatit relacionin teknik shoqërues, të cilin e dorëzon brenda 22 ditëve pune nga data e urdhrit fillestar.

11.Shtyrja e afateve

Nëse grupi i punës nuk mund të përmbushë afatin prej 22 ditësh pune për arsye objektive, paraqitet kërkesë e arsyetuar për shtyrje, me miratimin e Titullarit ose Drejtorit të Drejtorisë.

12.Miratimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike dhe relacioni shoqërues paraqiten për miratim tek Administratori i OBP-së. Pas miratimit, procesi vijon në fazën e dytë të punës.

13.Testimi i Tregut – Procesi i Unifikimit të Çmimeve

Faza e testimit të tregut zhvillohet vetëm pas marrjes së autorizimit përkatës, të dhënë me Urdhër të Brendshëm nga Administratori i OBP-së. Ky autorizim garanton që procesi të kryhet në përputhje me kërkesat procedurale dhe të mbështetet nga burimet e nevojshme organizative.

Për sigurimin e kontakteve të operatorëve ekonomikë, Sektori i Standardizimit dhe Unifikimit, në bashkëpunim me Komisionin e Vlerësimit të Ofertave (KVO), mbështetet në praktikat e mëparshme të punës dhe në databazat institucionale, si dhe përdor adresat elektronike apo numrat e telefonit të operatorëve pjesëmarrës në procedurat e mëparshme të prokurimit. Për një shtrirje më të gjerë, verifikohet gjithashtu edhe regjistri zyrtar i operatorëve ekonomikë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB).

5. Metodologjia e Përcaktimit të Çmimeve Mesatare

- Për përlllogaritjet e çmimit mesatar për njësi të artikujve të katalogut, grupi i punës mbështetet në nenin 76 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.
- Kur është e mundur, zbatohet pika 1/a e nenit të sipërcituar, duke marrë si referencë çmimet e publikuara nga INSTAT, si dhe çmime të tjera

zyrtare të njohura nga institucionet përkatëse (p.sh., organet tatimore dhe doganore, dhomat e tregtisë, manuale të specializuara etj.).

- Kur përdoret pika 1/b e nenit 76, grupi i punës analizon çmimet e ofruara nga operatorët ekonomikë, duke identifikuar çdo anomali (çmime të pazakontë të ulëta apo të larta) që nuk përputhen me nivelin e tregut ose me të dhënat e operatorëve të tjerë ekonomikë.

Metodat e Testimit të Tregut

- Kryerja e matjeve dhe krahasimeve direkte në terren;
- Përdorimi i platformave tregtare online;
- Referenca ndaj çmimeve të kontratave të mëparshme, të realizuara nga OBP-ja apo nga autoritete të tjera kontraktore;
- Përdorimi i çmimeve ndërkombëtare të publikuara në burime të besueshme.

Kriteret për Mbylljen e Procesit:

Pasi sigurohen jo më pak se tre (3) oferta ekonomike të vlefshme për secilin artikull, grupi i punës llogarit çmimin mesatar për njësi. Të dhënat përfundimtare përfshihen në një tabelë të detajuar, e cila bashkëngjitet me një relacion teknik të posaçëm për testimin e tregut dhe i paraqitet Administratorit të OBP-së për miratim.

6. Rishikimi dhe Përditësimi i Katalogut

Periudha standarde për hartimin ose rishikimin e një katalogu është një (1) herë në vit. **Ky afat mund të ndryshohet në rastet kur:**

- Lind nevoja për rishikimin e specifikimeve teknike si rezultat i një numri të madh kërkesash për sqarim ose ankesash nga operatorët ekonomikë;
- Lind nevoja për përditësimin e standardeve të artikujve të përfshirë në katalogët e miratuar;
- Për arsye të ndryshme, shfaqet domosdoshmëria e ritestimit të tregut.

7. Publikimi i Katalogut

Pas miratimit nga Administratori i OBP-së, grupi i punës ia përcjellë katalogun sektorit të IT-së për të bërë publikimin në platformën Albzone. Pas publikimit në faqen zyrtare të institucionit, katalogu i përcillet me e-mail autoriteteve kontraktore dhe në rrugë zyrtare Agjencisë së Prokurimit Publik (APP).

8. Sekreti Profesional dhe Etika në Punë

Të gjithë anëtarët e përfshirë në procesin e standardizimit dhe unifikimit janë të detyruar të respektojnë këto parime themelore:

- Ruajtja e konfidencialitetit të të dhënave teknike dhe tregtare;
- Respektimi i parimit të paanshmërisë dhe objektivitetit;
- Mosmarrja e kontakteve të paautorizuara me operatorë ekonomikë.

9. Modele dhe Praktika Ndërkombëtare në Përdorimin e Katalogëve të Standardizuar

Ky manual paraqet raste studimore nga vendet e Bashkimit Evropian dhe disa vende nordike që operojnë sipas modelit të BE-së, të cilat përdorin katalogë të standardizuar për mallra dhe shërbime. Qëllimi është të identifikohen praktikat më të mira dhe të nxirren mësimet të zbatueshme për kontekstin tonë kombëtar.

Raste Studimore

Itali — Consip / “Acquisti in Rete”

Consip, nën Ministrinë e Ekonomisë, operon portalin kombëtar të blerjeve publike me marrëveshje-kuadër dhe katalogë elektronikë (MEPA) për mallra/shërbime standarde. Administratat porosisin direkt nga katalogu ose bëjnë mini-gara brenda marrëveshjes; flukset janë tërësisht dixhitale.

Mësimi për ne: Model për kombinimin e e-catalog dhe mini-kompeticionit me integrim të klasifikimeve për krahasim të shpejtë.

Francë — UGAP

Qendra kombëtare e blerjeve me mbi 700,000 produkte/shërbime për blerje të menjëhershme nën marrëveshje kuadër, të publikuara në katalog online. Publikon katalogë të rinovueshëm dhe shton produkte të reja si shërbimet cloud dhe autobusë elektrikë.

Mësimi për ne: Ritëm i lartë përfitësimi dhe fokus në kategori strategjike.

Gjermani — Kaufhaus des Bundes (KdB)

Platformë qendrore me e-katalogë dhe kontrata për mbi 480 institucione federale. Aktualisht po modernizohet në versionin 'KdB Next Generation' për të përmirësuar ndërfaqen dhe integrimet.

Mësimi për ne: Standardizim i fortë i të dhënave dhe modernizim ciklik i platformës.

Spanjë — DGRCC

Njësia qendrore e Ministrisë së Financave operon katalogun qendror dhe marrëveshje-kuadër/DPS për mallra dhe shërbime. Po zëvendëson aplikacionin Conecta-Centralización për menaxhim më efikas.

Mësimi për ne: Ndërfaqe katalogu për kërkim produktesh dhe menaxhim i centralizuar i DPS/AM.

Portugali — CNCP

Entidade de Serviços Partilhados menaxhon Katalogun Kombëtar të Blerjeve Publike, pjesë e SNCP. Ofron akses të unifikuar për entitetet dhe autentikim unik për përdoruesit.

Mësimi për ne: Model i qartë i katalogut kombëtar me kanale të standardizuara të të dhënave.

Suedi — Statens Inköpscentral / Avropa.se

Organ qendror që negocion dhe menaxhon marrëveshje-kuadër për agjencitë shtetërore. Publikon marrëveshjet dhe udhëzimet për porosi në platformën Avropa.se.

Mësimi për ne: Prezantohet qartë gama dhe statusi i marrëveshjeve për thjeshtësi përdorimi.

Finlandë — Hansel Ltd.

CPB nën Ministrinë e Financave që përdor marrëveshje-kuadër me katalogë dhe etiketa të përgjegjësisë (green/social).

Mësimi për ne: Integrim i kriterëve të gjelbra dhe raportim për impaktin ekonomik dhe mjedisor.

Danimarkë — SKI

CPB kombëtare për shtetin dhe komunat me marrëveshje-kuadër dhe specifikime të standardizuara. Përfshirje e grupeve të punës nga administrata për dizajnimin e katalogëve.

Mësimi për ne: Përfshirje e sistematizuar e palëve për rritje të adoptimit.

Elementet e Përbashkëta të Suksesit

Nga këto modele dalin disa elemente kyçe:

- Platforma dixhitale me katalogë të kërkueshëm dhe procedura të thjeshta për porosi.
- Kombinim marrëveshjeve-kuadër me katalogë elektronikë.
- Raportim transparent mbi kursimet dhe impaktin.
- Klasifikim i unifikuar i artikujve për analizë dhe gjurmueshmëri.
- Përfshirje e kriterieve të gjelbra dhe sociale në specifikime.

Rekomandime për Zbatim

1. Zhvillimi i një platforme online kombëtare me funksion kërkimi, krahasimi dhe raportimi automatik.
- 2.Integrimi i kriterëve të gjelbra dhe inovative në çdo kategori.
- 3.Vendosja e detyrueshmërisë ligjore për përdorimin e katalogëve në kategori strategjike.
5. Raportim vjetor publik mbi impaktin e katalogëve për transparencë dhe llogaridhënie.

10. Dispozita të Fundit

Hartimi i këtij manuali siguron zbatimin rigoroz të të gjitha fazave të procesit të punës në Sektorin e Standardizimit dhe Unifikimit, duke mundësuar realizimin e katalogëve të standardeve që i shërbejnë autoriteteve kontraktore gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit. Zbatimi i tij garanton transparencë, efikasitet dhe barazi për të gjithë pjesëmarrësit në proces.

Në mbyllje, OBP-ja riafirmon angazhimin e saj të palëkundur për:

- Integritet absolut në çdo hap të procesit;
- Shërbim të ndershëm për çdo autoritet kontraktor;
- Mbrojtje të interesit publik mbi çdo interes tjetër.

Ky katalog është premtimi i mbajtur se standardet më të larta teknike dhe ekonomike do të jenë gjithmonë udhërrëfyesi ynë.

Zbatimi i tij i plotë është një hap drejt një sistemi prokurimesh publike më të drejtë, më efikas dhe më të besueshëm, një model që meriton të jetë shembull për çdo institucion.

Ky dokument hyn në fuqi pas miratimit nga Administratori i OBP-së dhe shpërndahet për zbatim të brendshëm brenda sektorit.